



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:147471

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05649452

KF.nr.325/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ, të paditësit Genci-AF N.T.SH me seli në Rahovec, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – Rivlerësim malli , vlerë kontesti e pa përcaktuar, jashtë seance me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr. 325/23 e datës 05.07.2023 e paditësit Genci-AF N.T.SH me seli në Rahovec për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.

A R S Y E T I M

Paditësi Genci-A” N.T.SH me seli në Rahovec, ka iniciuar në këtë Gjykatë kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr.01.3.2.2/7852 i datës 22.05.2023, objekt kontesti – rivlerësim malli , vlerë kontesti e pa përcaktuar.

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjijt edhe vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësor për padi bazuar në vlerën e kontestit, ndërsa sipas paragrafit 5, të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirin e tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marr për bazë faktin si më lartë, është konstatuar se këtu paditësi e ka pranuar vërejtjen për taksën gjyqësore për padi me datë 06.03.2024, mirëpo as brenda afatit ligjor, dhe as deri në nxjerrjen e këtij aktvendimi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi. Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë kontest tregtar administrativ komfor nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marr parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.325/2023, datë 02.05.2024

G j y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.